



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 95, datë 23.05.2025

PËR

**“TRANSFERIMIN E PROKURORIT GËZIM VEIZI NË PROKURORINË PRANË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË, NËPËRMJET PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me pjesëmarrjen e:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 23.05.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 18 e vijues të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Transferimin e prokurorit Gëzim Veizi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:



Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 1399 prot., datë 22.05.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës (në vijim Komisioni), pasi dgjoi relatorin zotin Sokol Stojani, si dhe diskutimet e zhvilluara në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim Këshilli) është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Me Vendimin nr. 13, datë 16.02.2024, "*Për shpalljen e 18 (tetëmbëdhjetë) vendeve vakante për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm*", Këshilli shpalli 18 (tetëmbëdhjetë) vende vakante në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Elbasan, Lezhë, Sarandë, Tiranë, Korçë, Kukës dhe Vlorë, të cilat do të plotësohen nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.

Njëri ndër vendet e shpallura është pozicioni vakant Nr. 4, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

3. Të dhënat lidhur me subjektet që kanë të drejtë të kandidojnë, kushtet ligjore, afati deri kur pranohen aplikimet etj, janë njoftuar në faqen zyrtare të Këshillit më datë 20.02.2024.
4. Pas përfundimit të afatit të aplikimit më datë 06.03.2024, Komisioni filloi punën me verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore nga ana e kandidatëve.
5. Në përfundim të këtij procesi Komisioni i propozoi Këshillit, miratimin e listës së kandidatëve të cilët kanë aplikuar brenda afatit. Me Vendimin nr. 37, datë 28.03.2024, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kualifikohen për të vijuar garën.
6. Në po të njëjtin vendim, Këshilli vendosi nëpërmjet procedurës së shortit caktimin e relatorit për secilin nga pozicionet e shpallura. Për pozicionin vakant Nr. 4, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë u zgjodh relator anëtar i Komisionit, z. Sokol Stojani.
7. Në zbatim të nenit 11, pika 1, të Rregullores "*Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele*" (në vijim Rregullorja), janë njoftuar kandidatët e kualifikuar për këtë pozicion, për fillimin e procedurës së vlerësimit të kandidatëve, si dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit, apo ndonjë anëtar i Këshillit, në rast të ekzistencës së një situatë konflikti interesi.
8. Meqenëse pas kalimit të këtij afati nuk ka pasur asnjë kërkesë për përjashtimin e relatorit apo të ndonjë anëtar i Këshillit është filluar puna për verifikimin e plotësimit të kriterëve të vlerësimit nga ana e kandidatëve, bazuar në nenin 43, pika 7, të Ligjit nr. 96/2016 "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar (në vijim Ligji për Statusin), si dhe nenet 16, 17, 19 dhe 41, të Rregullores.



9. Për pozicionin vakant Nr. 4, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, janë kualifikuar kandidatët, si më poshtë¹:

- i. Aida Cakaj, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (preferencë e parë);
- ii. Alma Bramo, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës (preferencë e tretë);
- iii. Englantina Shehu, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, (preferencë e dytë)
- iv. Enkeleda Hoxha, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës (preferencë e dytë);
- v. Erjon Shqarri, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë (preferencë e dytë);
- vi. Ervisa Hyka, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (preferencë e dytë);
- vii. Gëzim Spahiu, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër (preferencë e tretë);
- viii. Gëzim Veizi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës (preferencë e parë);
- ix. Gjergji Ceka, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë (preferencë e tretë);
- x. Iva Harka, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë (preferencë e tretë);
- xi. Neritan Hoxha, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan (preferencë e dytë);
- xii. Riselda Fishta, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës (preferencë e tretë);

10. Ndërkohë, prokurori Neritan Hoxha është shkarkuar nga detyra me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

11. Në vijim, prokurorët Aida Cakaj, Alma Bramo, Enkeleda Hoxha, Erjon Shqarri, Ervisa Hyka, Gëzim Spahiu, Gjergji Ceka, Riselda Fishta dhe Iva Harka kanë paraqitur kërkesë për tërheqje nga gara, kërkesa të cilat janë administruar në Këshill, si vijon:

- i. Alma Bramo – Kërkesë nr. 829/1 prot., datë 06.03.2025;
- ii. Aida Cakaj – Kërkesë nr. 832/3 prot., datë 06.03.2025;
- iii. Riselda Fishta – Kërkesë nr. 838/1 prot., datë 07.03.2025;
- iv. Gjergji Ceka – Kërkesë nr. 807/3 prot., datë 07.03.2025;
- v. Gëzim Spahiu – Kërkesë nr. 823/1 prot., datë 07.03.2025.
- vi. Erjon Shqarri – Kërkesë nr. 837/2 prot., datë 20.03.2025;
- vii. Ervisa Hyka – Kërkesë nr. 1028 prot., datë 21.03.2025;

¹ Renditja e kandidatëve është bërë sipas rendit alfabetik të emrave.



viii. Enkeleda Hoxha – Kërkesë nr. 602/1 prot., datë 29.04.2025;

ix. Iva Harka – Kërkesë nr. 644/2 prot., datë 05.05.2025.

12. Për sa më sipër, për pozicionin vakant Nr. 4, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, kandidatët që mbeten në garë janë (sipas rendit alfabetik) si më poshtë:

i. **Englantina Shehu**, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, (preferencë e dytë)

ii. **Gëzim Veizi**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës (preferencë e parë).

13. Pas miratimit nga Këshilli në këtë mbledhje, të transferimit në detyrën e prokurores Englantina Shehu në pozicionin vakant Nr. 2, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nëpërmjet lëvizjes paralele, prokurori Gëzim Veizi ka mbetur i vetmi kandidat i kualifikuar.

14. Për rrjedhojë kandidati Gëzim Veizi renditet i pari, duke mos kaluar në vlerësimin krahasues të treguesve, të kriterëve dhe përparësive të tjera sipas të Ligjit për Statusin dhe Rregullores, si dhe vijohet me transferimin nëpërmjet lëvizjes paralele në detyrë të prokurorit në këtë pozicion.

15. Kandidati Gëzim Veizi, me Dekretin nr. 8206, datë 28.05.2013, të Presidentit të Republikës është emëruar prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës. Aktualisht, prokurori Gëzim Veizi ka rreth 10 vjet (128 muaj) vjetërsi pune si magjistrat, si përvojë profesionale specifike në atë shkallë për të cilën kandidon.

Për sa më sipër Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

16. Duke pasur në konsideratë sa më sipër, Këshillit i duhet të analizojë nëse janë të zbatueshme në këtë rast, parashikimet e nenit 43, pika 11, të Ligjit për Statusin, që referon për zbatim nenin 41, pikat 2 deri në 4, të tij, të interpretuara bashkërisht me nenet 44 dhe 22, të Rregullores që parashikojnë të drejtën për ankim në gjykatë, pasi është bërë renditja e kandidatëve.

17. Pavarësisht se e drejta për akses dhe ankim në gjykatë është një e drejtë kushtetuese, parashikuar nga nenet 42 dhe 43, të Kushtetutës, e detajuar më tej në legjislacionin e sipërcituar, Këshilli vlerëson se, në këtë rast gjen zbatim parashikimi i nenit 18, të Kodit të Procedurave Administrative, titulluar “*Parimi i deburokratizimit dhe i efijensës*”, i cili në pikën 2, të tij parashikon se: “*Procedura administrative zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj për të, me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm*”.



18. Referuar përmbajtjes së kësaj dispozite, rezulton se aplikimi i këtij parimi kërkon që të plotësohen kumulativisht këto kushte:

- a) procedura të zhvillohet sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj për të;
- b) me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët;
- c) në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm;

19. Bazuar në tërësinë e rrethanave faktike të përshkruara më sipër në këtë vendim, rezulton se këto tre kushte plotësohen pasi, *së pari*, qëllimi kryesor që procedura të zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur. Duke eliminuar pritjen e afateve ankimore, për subjekte që kanë deklaruar heqjen dorë nga procedura për këtë pozicion të lëvizjes paralele, atëherë procedura zhvillohet shumë më shpejt, duke përfutur të pakën 7 (shtatë) ditë kohë.

20. *Së dyti*, edhe kriteri i dytë rezulton që të plotësohet në këtë rast, pasi procedura ul kostot si për organin publik, Këshillin në këtë rast, ashtu edhe për prokurorin që ka ngelur si kandidat i vetëm në këtë procedurë. Kjo përforcohet nga fakti se pjesa tjetër e prokurorëve që kanë kandiduar u tërhoqën nga kjo procedurë me vullnetin e tyre, duke i hequr Këshillit nevojën për një analizë të thelluar krahasuese midis aplikuesve dhe shmangur krijimin e një situatë që do të kërkonte përdorimin e mëtejshëm të burimeve njerëzore. Gjithashtu, përderisa për këtë pozicionin mbeti vetëm një kandidat që plotëson të gjitha kriteret ligjore, renditja dhe caktimi i tij realizohet menjëherë pa e zgjatur më tej procedurën me hapa të tjerë formalë.

21. *Së treti*, rezulton që edhe kriteri i tretë plotësohet në këtë rast, pasi emërimi i prokurorit Gëzim Veizi në këtë pozicion nuk shmang asnjë hap apo procedurë që duhej ndjekur sipas legjislacionit në fuqi, si edhe nuk shkel të drejtat e palëve të interesuara. Duhet theksuar se sipas përkufizimit që jep Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 3, pika 7, germa "a" të tij, rezulton se: "*Palë*" është: a) *çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi;*" Më tej neni 33, pika 1 e këtij Kodi parashikon se: "*1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person: a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative;*"

22. Bazuar në këto parashikime rezulton qartësisht se, të gjithë prokurorët që kandiduan për këtë procedurë të lëvizjes paralele, janë palë në këtë procedurë administrative. Po më tej, Kodi i Procedurave Administrative në nenin 64, pikat 2 dhe 4 të tij, parashikon se: "*2. Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjore, përveç rasteve kur kjo ndalohej me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. ... 4. Tërheqja e një pale nuk çon në përfundimin e procedurës administrative, në rast se organi publik vlerëson se vazhdimësia e procedurës është në interes publik ose në interesin e ligjshëm të palëve të tjera.*". Ndodhur përballë këtyre kushteve rezulton se, prokurorët e tjerë, kandidatë në këtë procedurë, u tërhoqën me vullnetin e tyre, përpara se Këshilli të shprehej



me vendim përfundimtar për këtë pozicion. Në këtë rast, duke qenë se mbetet një kandidat, Këshilli në bazë të nenit 64, pika 4 e këtij Kodi, vijon me procedurën administrative, për realizimin e interesave të ligjshme të këtij prokurori.

23. Për të gjitha këto arsye, pezullimi i procedurës së lëvizjes paralele, për të respektuar një afat ankimor, kur ka mbetur vetëm një kandidat në këtë procedurë, i cili plotëson kriteret për t'u kualifikuar, do të sillte një zvarritje të pajustificuar të procedurës administrative. Për rrjedhojë, Këshilli vlerëson se zbatimi i nenit 18, të Kodit të Procedurave Administrative në këtë rast është i justifikuar, proporcional dhe në përputhje me parashikimet ligjore, duke i shërbyer jo vetëm efikasitetit procedural, por edhe garantimit të një vendimmarrjeje të arsyetuar dhe të ligjshme.

24. Sa i takon hyrjes në fuqi të aktit dhe krijimit të pasojave, në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit të prokurorisë dhe kalimi të detyrës në mënyrë graduale, vlerësohet aplikimi i pikës 3, të nenit 104, "*Fillimi dhe përfundimi i pasojave juridike të aktit administrativ*", të Kodit të Procedurave Administrative ku përcaktohet se:

"1. Një akt administrativ fillon të sjellë pasoja juridike ndaj palës së cilës i drejtohet apo interesat e së cilës preken nga akti, me njoftimin e përmbajtjes së aktit palëve.

2. Akti administrativ i miratuar në heshtje fillon të sjellë pasoja juridike, në ditën e përfundimit të afatit për njoftimin e tij, sipas nenit 97 të këtij Kodi.

3. Një akt administrativ mund të fillojë të sjellë pasoja juridike në një datë tjetër, të caktuar shprehimisht nga vetë akti, por në asnjë rast përpara njoftimit të palës, sipas pikës 1 të këtij neni. Në këtë rast, data e fillimit të pasojave juridike caktohet shprehimisht në pjesën e dispozitivit të aktit administrativ të shkruar.

4. Një akt administrativ sjell pasoja juridike:

a) për sa kohë nuk është anuluar apo shfuqizuar, kryesisht apo si rezultat i ushtrimit të mjeteve ligjore administrative ose gjyqësore;

b) për sa kohë nuk ka përfunduar afati i aktit ose nuk është përmbushur qëllimi i tij; ose

c) për çfarëdo arsyeje tjetër të parashikuar nga ligji."

25. Referuar sa më sipër, pasojat juridike të aktit administrativ dhe fillimi i ushtrimit të detyrës efektive në zyrën e prokurorisë pritëse, në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit të prokurorisë, do të krijohet në një moment të dytë, konkretisht në datë 09.06.2025.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa "a", të Kushtetutës, në nenet 18, pika 2, 90, pika 2, dhe 104, pika 3, të Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", në nenet 42 dhe 43, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166, pika 2, 189, pika 1, germa "a", të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe në nenet 43-45, të Rregullores "Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele", e ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,



VENDOSI:

Transferimin e prokurorit Gëzim Veizi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.

2. Marrëdhëniet financiare që lidhen me pagën dhe përfitimet e tjera do të përballohen nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë duke filluar nga data 09.06.2025.
3. Të njoftohen për këtë vendim prokurori Gëzim Veizi, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 23.05.2025.



KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Erind Merkuri

ZV/KRYETAR
Erind Germenji

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Erion Fejzulla